

LIRINDJA #03



ÇKA M'KA MËSU ARBENI

Hana Marku

I kam 25 vjet, dhe jam kthj në Prishtinë, midis atij dimrit të madh e pa ujë. Një shoqe e jemja kroate që kishte qenë në Kosovë në vizitë, kishte pasë një mosmarrëveshje me pronarin e banesës së saj të përkohshme, dhe kështu e la banesën pa pagu 75 euro faturë të rrymës. Aty fillon shoqnia jeme e bukur me Arbenin, pronarin e banesës, i cili per fatin tem "të mirë" e ka numrin tem të telefonit. Mesazhet shpejt kalun prej lutje ne kercënime, të llojit *e-di-ku-jeton*, *e-di-ku-punon*, *ski-me-i-vyjt-as-familjes-kur-te-kry-me-ty*, *ki-deri-neser*, *mendo-për-familjen-tande*, dhe formulime tjera të tilla.

Policja në Stacionin 3 të Dardanisë më thotë, "kërcënimet me SMS jane bo shumë. Na i konsiderojmë këto si gjysëm-kërcënime." Çështja nuk zgjidhet derisa nuk paraqiten dy eprorë burra, njëri prej tyre më plak, dhe tjetri më i ri. Deri në këtë moment, nuk ma kanë shënu as numrin e telefonit, as emrin (s'di pse prita diçka nga skenat e CSI-t: hapja e dosjes, shkrimi i një raporti te detajizuar, një police kompetente dhe empatike që thotë: "we won't let them get away with this!")

Në mungesë të kësaj, e shoh veten tu i rrefy policëve qysh jetoj vet, qysh familjen e kam në Kanadë, s'ka kush me m'mbrojt, që po tutna me shku në shpi - dhe - fatmirësisht, po shoh që po ju

dhimbsem. Polici plak e merr telefonin tem, dhe e thërret Arbenin në dhomën tjetër, ku ma merr mendja polici plak, si burrë me autoritet të shtetit dhe të moshës, e "tuti" Arbenin dhe më morri nën mbrojtje. "Këtu si duket hala çon peshë fjala e burrit!" tha policja, pasi që u zgjidh çështja ime midis burrave.

Nuk pata nevojë ma me u marrë me Arbenin, po sendi që mbaj në mend nga ajo ditë ka qenë panika jeme që nuk kanë me më marrë seriozisht, pa nënvizu faktin që jam femër, dhe jetoj vet. Tu e lujt rolin e gjynahes, nje çikë e re pa babin afër e pa burrë, mbrriva me marrë ndihmë. E ai fakt m'boni nervoz. Por, sado që është irrituese për shoqet e mia të edukuara, të punësuar dhe të emancipuara, është ma lehtë me fitu empati ne këtë shoqni si gru, se sa respekt. Kjo s'është diçka që e kam studiu në mënyrë serioze, kështu që nuk muj me iu referu studimeve apo teorive të verifikuara për këtë hipotezën teme, por muj me i nda me juve disa momente që ma konfirmojnë këtë qëndrim, së paku sipas meje:

1. Pas një seri të vrasjeve të vajzave dhe grave në Shqipni, yjet e estradës shqiptare dolën me një klip në Top Channel, me nofkën, *Mos i vrisni vajzat*. Një mbrapavijë e zezë, dhe ftyrat e Aurela Gaçës, Ben Blushit, Ardit Gjebreas, dhe Alban Skenderajit, tu tregu që s'bon "me vra qenien që ju sjellë në jetë," "vetëm burri vret burrin," dhe "lëri ato të jetojnë."

2. Qasja e Top Channel-it, megjithatë, ka qenë më pak patetike se sa kampanjat vjetore të *Gjashtëmbëdhjetë Ditë të Aktivizmit në Kosovë*, që kanë për synim me eduku popullin mbi dhunën në baza gjinore me video të ngjajshme

vetëdijësuese. Në vitin 2013, videoja e kampanjës përmbante intervista të shkurta me aktorë dhe muzikantë nga Kosova që thojshin gjëra si "mos i ngucni gratë", dhe përfundoi me një vajzë të vogël tu thonë (tu lexu si duket, me shumë kujdes nga një pankartë mbrapa kamerës) "dua të shkoj në fakultet dhe të bëhem artiste. Më ndihmo që të realizoj ëndrrën time. Thuaj jo dhunës ndaj vajzave dhe grave."

3. Monumenti akoma i pandërtuar i quajtur *Heroinat*, është mishërim i pamundësisë tonë për me pa gratë si aktere me fuqi të plotë, jashtë kornizës së qenies së dobët që duhet m'u mbrojtë. *Heroinat* herë përshkruhen si monument i kushtuar kontributit të krejt grave të Kosovës, e herë si monument i kushtuar grave të përdhunuar gjatë luftës. Të dy intepretimet si duket janë të qëllimshme, meqë monumenti tregon ftyrën e një gruaje - ftyrë e përbërë nga 20,000 medale, që simbolizojnë 20,000 gratë që mendohet se janë përdhunu gjatë luftës në Kosovë.

Me këtë interpretim të dyfishtë, kontributet e ushtarëve, mjekëve, mesuesëve, dhe aktivistëve gra që punuan për pavarësinë e Kosovës krahas burrave reduktohen në përdhunim. Cënimi i trupit konsiderohet si sakrificë dhe kontributi më i lartë i gruas, duke lënë historitë të veprimt, rrezikimit dhe luftimit të barabartë të grave me burrat mënjane. Mos m'keqkuptoni, duhet të nderohen të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, por kjo duhet me qenë e shoqëruar me përpjekje serioze për të sjellur drejtësi për ato krime. Problemi te *Heroinat* qëndron te glorifikimi i gruas si qenie e dobët dhe viktimë, e cila s'ka mujtë (si duket) në asnjë mënyrë

tjetër me qenë kontribuese aktive në çlirimin e kombit pos me "sakrificën" e trupit të saj - gjë që e dijmë është totalisht jo e vërtetë historikisht dhe që i nënvlerëson gratë e Kosovës në mënyrë të tmerrshme.

Këto janë narativa të nënvetdijshme, të normalizuara aq bukur sa që çdo kritikë kundër infantilizmit që ato shprehin mund të cilësohet si kundër grave. Kufijtë për të imagjinuar një grua si qenie të plotë, me fuqi mbi vetën dhe fatin e saj, janë të mbyllur. Pos nëse insistojmë t'i hapim ato. Duhet me u lëvdu përpjekjet e disa shkrimtareve dhe regjisoreve shqiptare në këtë aspekt, në ofrimin e narrativave të reja mbi të vepruarit dhe të jetuarit si gru. Këta shembuj më poshtë janë shembujt më shpresëdhënës, sipas meje:

1. Përmbledhja e tregimeve të shkurta të Ornela Vorpsit, *Vendi ku nuk vdes kurrë*, paraqet anën ma të errët të të qenit gru në Shqipninë para dhe pas-komuniste. Personazhet në tregimet e saja gjysëm-autobiografike jetojnë në një Shqipni të shëmtuar, ku vajzat e bukura cilësohen si lavire në momentin që hyjnë në pubertet, ku dhuna ushtrohet dhe trashëgohet nga burrat dhe gratë, ku i vetmi respekt është për të vdekurit. Por kjo nuk i definon personazhet e saja, pa marrë parasysh nënshtrimin dhe dhunës që ushtrohet ndaj tyre. Ato vazhdojnë me jetu, me mendu, dhe me rezistu - ka bukuri, dhe ka liri per to.

2. *Hana* nga shkrimtarja Elvira Dones arrin të njëjtin efekt, në romanin e saj mbi një burrneshë e Shqipnisë veriore e cila vendos me imigru në SHBA, dhe m'u bo "gru" prapë. Vendimi per m'u bo burrë, e gru prap, nuk paraqitet në

terma tradicionale (*mbeta pa burrë e pa fëmijë, kuku*), por si një çlirim, si një rikthim tek vetvetja.

3. Filmi i shkurtë i regjisorës Antoneta Kastrati, *Ajo vjen në pranverë*, tregon Agnesin, një gru e re në kërkim të vrasësit të nanës së saj gjatë luftës. Ballafaqimi, kur ndodhë, është i fuqishëm, dhe thyen nocionet tona të të qenit viktimë. Njësoj mundet m'u komentu mbi filmin e shkurtë *Kthimi* nga Blerta Zeqiri, tregimi i të cilit përqëndrohet te një çift që bashkohet disa vite pas luftës, dhe asaj se çka ndodhë kur gruaja i tregon burrit për përdhunimin e saj gjatë luftës. Edhe këtu, ballafaqimi është në rradhë të parë i fuqishëm dhe njerëzor. Përfundon me një ndjenjë të mbijetesës dhe shpresës. Gratë e Kastratit dhe Zeqirit nuk janë viktima të depersonifikuara, dhe kjo është shumë e rëndësishme.

Kjo dikotomia midis të qenit gru-viktimë që duhet m'u mbrojtë, dhe të qenit burrë i fortë i cili mbronë, është e rrejshme. Jetojmë në një rend shoqëror ku rregulli i "ma t'fortit" mbizotëron, dhe ku të gjithë ne, burrat edhe gratë, në një moment ose tjetër jemi të dobëta dhe viktima.

Dhuna dhe pushteti ushtrohet dhe pranohet te na, qarkullon në familjet dhe rrethet tona, aq e normalizuar sa që shumicën e kohës as që e vërejmë ushtrimin e saj. Gratë dhe vajzat, për shkak të patriarkalitetit të rrënjosur në shoqëritë shqiptare, janë caqet më të zakonshme të kësaj dhune. Nëse kundërpergjigja jonë e vetme ndaj kësaj dhune të normalizuar është "mos i vrisni vajzat" dhe "mos i ngucni gratë" kemi dështu që në start. Në këtë konstalacion fjalësh "lëri ato te jetojnë," "më

ndihmo," "qenie që lindë jetë," e kuptojmë këtë gru shqiptare jo si njeri me dinjitet të lindur, po si qenie e dobët dhe e vobekët, për gjynah.

Për me ndryshu hierarkitë tona dhe rregullat e pathëna që i kemi marrë si të vërteta, na duhet një ri-imagjinim i vetvetes. A mundemi me paramendu një botë shqiptare ku gratë janë njerëz, dhe trajtohen si të tilla? A mundemi me paramendu gra të cilat nuk janë viktima të përhershme? A mund të paramendojmë gra dhe burra që posedojnë një liri të lindur dhe të brendshme, dhe një shoqni që nuk e ngulfatë atë liri që nga fëmijëria? Nëse mundemi me paramendu këtë botë, s'ka asnjë arsye pse nuk mundet me u kriju.

AND ALL THAT QUEER

Marija Obradović
përktheu: Petrit Çeku

Nuk m'pëlqejke
Kur m'merrshe nëpër darka
për me m'qi
para gjumit
e që u dojshim.
Ashtu në normativë
Kur m'palojshe tamam
Si gru ashtu.

Nëse me mendje s'mundesh me
m'rrokë
Atëherë zvarritu, qallamitu me gjuhë deri
n'tokë.
Po ti s'po don,
Se vallahin tamam je burrë.

Ma mirë me ia ly thonjt'
Shoqes *transgender*
E m'u qi me asi kuklla
Në stacionin e trenit,
Me ngu *jazz me all that queer*
Se me ty me hangër djath t'mykt'
Me venë t'mirë e seks t'keq.

Ma mirë e boj *squat*
Kët' kotecin tem
Për një macë që don m'u ngre
Nji cimer pa punë
Dhe të dashurën e tij
Le t'bojn *BDSM*
Në kuzhinën teme,
Se me ta dhon' ty bōthën.

Ma mirë i mshoj
Me ate zoqkën në pornsajt
E bona e bija e Bettie Page
Se me i vesh ato kompletet drap

Ti tu m'shetit nëpër shopping
And all that queer.

Ma mirë e luj
Porno partizanen dhe partizanin
Në paralagjet e braktisuna industriale
Te Beogradit post-apokaliptik
Me atë që nuk është gjithmonë ktu
Se sa me ta dhonë ty
Raportin ditor
E seksionin e së dielës
And all that queer.



VDEKJA E PRINDËRVE NË FSHAT

Dragoslava Barzut
përktheu: Petrit Çeku

Për kryeshnosh erdhi gjithë farefisi dhe fqinjët.
Nuk njoh askë.
Vdekja e prindërve në fshat ka ndodhur moti në të ardhmen
Nuk mund ta evokoj. Nuk mund të qaj.
Pas një sëmundjeje të rëndë dhe të gjatë, vdekja e tetëorëshit të tyre në punë,
ndodhi papritmas, pa u vërejtur

Lajmin e përhapi vetëm faqja lokale e fejsbukut:
Vdiq familja, duke i lënë pas "edhe tre vite DERI në penzion"
Varrimin e financon e bija, lezbike.

Kohëve të fundit mirëmbanin kuzhinën sllovene dhe garniturën e lekurës
por jo edhe kontaktet.

Rendisnin lulet që nga vitet e stazhit, vdiqën jo krenarë, në mua.
Se nuk kam punë stabile, burrë e tre fëmijë
Treshen e shenj të cilën nuk e zuri banesa

Ndërtuan shtëpi familjare
Jo me kokë, jo me gjymtyrë, jo me gjithë trupin por vetëm me dhjetë gishta
Ndërtuan një shtëpi më të madhe se ëndrrat e tyre
më të madhe se vëllezërit dhe motrat
shokët e shoqet
shtëpi që do të bëhet varrezë e jetërave tona të rimontuara

Vdekja e prindërve në fshat ka ndodhur moti në fëmijëri
e cila mund të hynte tërësisht në paketën e nënës për vitin e ri
Në paketimin e *stërfryer* të *smoki-t* të madh dhe të ngjithshëm
Dhe në çokolladën me oriz.
Dhurata ma e shijshme e nëntëdhjetave.

HERETIKU

Biljana Kosmogina
përktheu: Petrit Çeku

Pash n'andërr mram'
që në botë janë
veç tre ngjyra:
perëndimore, lindore, jugore e veriore.
Kur përnjihëri Krijuesi m'pyti:
"Cili lloj je ti?"
e unë e humbun
masi u ngushtova pak
thashë: vnerorja

U dridha, u zgjova, u ngrita,
kur! në pasqyrë
nji pinguin i madh e i tërbum
barkun e bardhë
frakun zift t'zi
sqëpin e kuq
sytë sari
të nximë nër.

U shashtrisa, traumatizova,
u tmerrova!!

Oqeani është larg... tepër.
Qysh me mbri në vendlindje
kur s'i kom letrat,
kartelat as paret?
Vështirë me ecë deri në Antarktik,
shumë lodhna.
Duhna me nxon' peshq
se duhna m'u ngi,
me qenë i fortë, m'i notu miljet, me
migru në tufa...
edhe m'u shumë duhna
e s'kom ku edhe me kon.
Kom me dekë uni
edhe s'kom m'u martu kurr'.

Këtu kërkush s'po m'kupton
e lene ma me m'pranu
se s'jom i llojit 'tyne
me tri gishtat nën kryq
e s'jom najfar dase
me asi sjellje edhe shtati
e hiç se hiç najfar rrace
perëndimore, lindore, jugore a veriore,
jom thjesht nji hasret
që i ka hup krejt,
njësi e vetmume, e pikllume
për do qesharake, por për shumicën - e
shëmtume.

I zhvendosun prej hapsinës dhe kohës
heretik jom
i hekun prej fisit.

Lirindja #3
Zinë e pamvarun

Prishtinë
Prill 2015

Kontribuesit:

Lura Limani, Rina Krasniqi, Hana Marku, Elona Kastrati, Erëmirë Krasniqi,
Bardhi Bakija, Eli Krasniqi, Petrit Çeku, Marija Obradović, Dragoslava Barzut,
Biljana Kosmogina, Shelbatra Jashari, Rita Parashumti, Nina Cara.

Ilustrimet:
Tadi

Faqosja:
Dritëro Mehmtaj